



MINISTRIA E DREJTËSISË

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

**ANALIZË STATISTIKORE
NDIHMA JURIDIKE E GARANTUAR NGA SHTETI**

Të dhëna statistikore mbi ndihmën juridike parësore dhe dytësore

PRILL 2022

DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Botim i Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas

© Ndalohet çdo prodhim, riprodhim, shitje, rishitje, shpërndarje, kopjim, fotokopjim, përkthim, përshtatje, huapërdorje, shfrytëzim, transmetim, regjistrim, ruajtje, depozitim, përdorje dhe/ose çdo formë tjetër qarkullimi tregtar, si dhe çdo veprim cenues me çfarëdo lloj mjete apo formë

Tabela e përmbajtjes

H Y R J E.....	3
KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore	6
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore	6
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuar.....	13
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve.....	18
Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjellbër 08001010	20
Numri i Gjellbër 08001010	20
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore	21
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas natyrës së çështjes)	23
Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore (sipas kategorisë përfituese).....	24
KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE.....	26
Të dhëna statistikore: Kategoria Femra / Meshkuj.....	26
Të dhëna statistikore: Kategoria përfituese me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.	27
Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të ofruar.	27
Të dhëna statistikore: Vendimi i Gjykatës / Organit procedues.	28
Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.	28
Të dhëna statistikore: Gjykata që ka dhënë vendimin.	29
KONKLUSIONE	31
Sa i përket ndihmës juridike parësore	31
Sa i përket ndihmës Dytësore	32
NDIHMA JURIDIKE PARËSORE JANAR-PRILL 2022.....	33
NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE JANAR-PRILL 2022	33

HYRJE

Qëllimi i këtij punimi është krijimi i një analize statistikore të unifikuar sa i përket sistemit të ndihmës juridike ashtu si kërkohet shprehimisht në ligjin nr. 111/2017, **“Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”** dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij e cila ndikon drejtpërdrejt në hartimin dhe zbatimin e politikave të mëtejshme në fushën e ndihmës juridike falas nga Ministri i Drejtësisë.

Referuar shkronjës “d”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, Drejtoria e Ndihmës Juridike, mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin e saj.

Gjithashtu, referuar shkronjës “gj”, neni 8 i Ligjit nr.111/2017, **Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga Ministri i Drejtësisë.**

Procedura e mbajtjes, mbledhjes, plotësimit si dhe administrimit të këtyre të dhënave është e përcaktuar shprehimisht në udhëzimin nr. 1, datë 08.03.2019, **“Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave”.**

Referuar këtij udhëzimi, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas është organi përgjegjës për mbajtjen, mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e:

a) Të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese të ndihmës juridike të garantuar nga shteti mblidhen në bazë të kërkesës për ndihmë juridike, vetëdeklarimit dhe çdo dokumentacioni tjetër të depozituar nga kërkuesi për këtë qëllim.

Në regjistrin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve për ndihmë juridike parësore dhe dytësore, për çdo kërkues, përfshihen të dhënat e mëposhtme:

- Kërkuesi (Emri, Mbiemri);
- Gjinia,
- Datëlindja,
- Shtetësia,
- Gjendja familjare (numri i pjesëtarëve në familje),
- Gjendja e punësimit,
- Adresa dhe të dhëna të tjera kontakti,
- Gjykata/Organi procedues pranë të cilit është dorëzuar kërkesa;

- Lloji i vetëdeklarimit;
- Lloji i ndihmës dytësore të kërkuar;
- Çështje juridike;
- Vendimi i gjykatës/organit procedues mbi kërkesën për ndihmë juridike;
- Data/Nr. i vendimit;
- Ankimim i vendimit;
- Pala ankimuese;
- Vendimi mbi ankimin;
- Avokati i caktuar;
- Pagesat e përfituara nga avokati;
- Rimbursimi i pagesave.

Udhëzimi parashikon se regjistri i kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve përfituese mbahet në formë elektronike dhe bëhen publike nëpërmjet faqes elektronike të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Regjistrat me të dhënat e plota, sipas këtij udhëzimi, mbahen pranë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas. Të dhënat e plota të regjistrave u vihen në dispozicion institucioneve të drejtësisë dhe palëve të interesuara, pasi vlerësohet qëllimi i kërkesës dhe në përputhje me kriteret dhe kufizimet e parashikuara në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

Punonjësi i autorizuar nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas

Drejtorja e Ndihmës Juridike Falas autorizon me shkrim punonjës për plotësimin dhe përditësimin e regjistrave. Punonjësi i autorizuar është përgjegjës për saktësinë dhe përditësimin e të dhënave të hedhura prej tij.

Gjithashtu, udhëzimi parashikon se punonjësi i autorizuar nuk mund të ndërhyjë dhe të ndryshojë rubrikat e regjistrave. Në rast se bëhen gabime materiale në hedhjen e informacionit në regjistër, punonjësi i autorizuar bën korrigjimin dhe shkruan informacionin e saktë. Regjistrat administrohen nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas dhe për ruajtjen dhe asgjësimin e tyre zbatohen rregullat e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për arkivat.

KREU I- Të dhëna statistikore mbi çështjet me objekt ndihmën juridike parësore

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore

Referuar nenit 13 të ligjit 111/2017, Ndihma juridike parësore jepet nga: ***Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore (përmes punonjësve me trajnim të posaçëm); Organizatat jofitimprurëse të autorizuara dhe Klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë.***

Qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë njësi të specializuara për dhënien e ndihmës juridike parësore. Që prej hyrjes në fuqi të ligjit nr. 111/2017, Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë kanë patur për qëllim kryesor evidentimin dhe hapjen e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore në ato qytete ku shërbimi i ndihmës juridike falas (ofruar në mënyrë autonome nga ana e organizatave të ndryshme joqeveritare) ishte i mangët ose inekzistent por nga ana tjetër, edhe nevojat e qytetarëve për ndihmë juridike falas ishin të mëdha.

Aktualisht, gjatë periudhës Prill 2022, Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas administron 10 (dhjetë) qendra të shërbimit të ndihmës juridike të garantuar nga shteti si vijon:

- ❖ **Tiranë** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Durrës** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Lezhë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Pogradec** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Lushnje** (me buxhetin e shtetit);
- ❖ **Shkodër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Gjirokastrë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Fier** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Dibër** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”);
- ❖ **Vlorë** (në bashkëpunim me UNDP në kuadër të projektit: “Mbi zgjerimin e shërbimit të ndihmës juridike parësore për gratë dhe burrat në Shqipëri”).


Qendra e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore	Totali i Rasteve të raportuara	Moshë		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Çështjes			Përkatësia Etnike	Viktima Dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative	Romë&Egjiptian)	
Specifikime															
Tiranë	56	-	56	28	28	56	-	16	9 (9 invalid)	31	31	7	18	-	-
Lezhë	23	-	23	9	14	23	-	18	5 (5 invalidë)	-	17	3	3	-	-
Durrës	28	-	28	18	10	28	-	24	4 (1 Viktimë dhune, 3 invalidë)	-	17	1	10	-	1
Lushnje	19	-	19	13	6	19	-	14	5 (2 viktima dhune, 3 ndihmë ekonomike)	-	18	-	1	7 romë	2
Shkodër	20	-	20	15	5	20	-	14	6 (2 viktima dhune, 3 KMCAP, 1 skema e mbrojtjes sociale)	-	16	4	-	-	2
Gjirokastrë	45	-	45	20	25	45	-	18	27 (1 Aftësi e kufizuar, 20 skema e mbrojtjes sociale, 3 invalid, 2 viktima dhune, 1 I verbër)	-	6	-	39	3 romë dhe 1 egjiptjan	2
Pogradec	18	-	18	8	10	18	-	13	5 (4 ndihmë ekonomike, 1 viktima dhune)	-	16	1	1	-	1
Fier	25	-	25	14	11	25	-	19	6 (2 skema e mbrojtjes sociale, 1 invalid, 1 person me aftësi të	-	8	1	16	-	1

									kufizuar, 1 i verbër, 1 viktimë dhune)						
Dibër	5	-	5	3	2	5	-	1	4 skema e mbrojtjes sociale	-	3	-	2	-	-
Vlorë	20	-	20	11	9	20	-	13	7 (3 aftësi e kufizuar, 4 skema e mbrojtjes sociale)	-	10	1	9	3 romë	-
TOTALI	259	-	259	139	120	259	-	150	78	31	142	18	99	14	9


Për muajin Prill 2022 janë administruar 259 raste nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore

Rastet për muajin PRILL


Qendrat e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore



**Rastet e raportuara nga Qendrat e Shërbimit të Ndihmës
Juridike Parësore sipas natyrës së çështjes**




**Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive
përfituese të përcaktuara në ligj**



- Me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme
- Kategori të Veçanta
- Papërcaktuar

Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë



Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga organizatat jofitimprurëse të autorizuara

OJF e Autorizuar	Total i Rasteve	Mosha		Gjinia		Shtetësia			Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e çështjes		
		Mitur	Rritur	F	M	Shqiptar	I huaj	Pa shtetësi	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Veçantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Admin
Specifikime														
“Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza” ¹	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
“Mbrotja e të drejtave të gruas qytetare dhe fshatare Berat”	5	-	5	3	2	5	-	-	-	-	5	2	-	3
“Qendra e shërbimeve dhe praktikave ligjore të integruara”	10	-	10	5	5	10	-	-	10	-	-	2	-	8
“Intelektualët e rinj shpresë” ²	6	-	6	2	4	6	-	-	6	-	-	3	-	3
CRCA	18	10	8	12	6	18	-	-	-	18	-	18	-	-
“Forumi i Gruas Elbasan”	9	-	9	9	-	9	-	-	6	3 viktima dhune	-	9	-	-
“Shërbimi Ligjor Falas (TLAS)”	46	6	40	22	24	46	-	-	46	-	-	-	-	46
“Të ndryshëm dhe të	22	4	18	19	3	22	-	-	-	22 (9 viktima dhune në familje; 10 viktimë	-	7	2	13


¹ Nuk janë raportuar raste për muajin Prill 2022

² 1 egjiptjan

barabartë”										<i>e mundshme trafikimi; 2 viktimë trafikimi; 1 abuzimi seksual)</i>				
“Albanian Legal and Territorial Institute “	21	-	21	15	6	21	-	-	-	-	21	21	-	-
“Qendra për nisma ligjore qytetare”	44	-	44	34	10	44	-	-	29	<i>15 (11 viktime dhune në familje; 3 pensionistë; 1 aftësi e kufizuar)</i>	-	29	4	11
“Shërbimet shqiptare për refugjatët dhe migrantët”	16	1	15	7	9	16	-	-	-	-	16	-	-	16
“Qendra Konsumatori Shqiptar”	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
TOTAL	197	21	176	128	69	197	-	-	97	58	42	91	6	100

Për muajin Prill 2022 janë administruar 197 raste nga OJF e autorizuar

Numri i rasteve të raportuara nga OJF e autorizuar



■ Series1

0

5

10

6

18

9

46

22


21

44


16

0


Numri i rasteve të raportuara sipas natyrës së çështjes



Numri i rasteve të raportuara sipas gjinisë



Numri i subjekteve përfitues sipas kategorive të përcaktuara në ligj



Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

Një ndër ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore janë edhe **Klinikat e Ligjit**. Bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 111/2017, Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kriterëve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore

Aktualisht Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas ka lidhur marrëveshje me 12 Institucione të Arsimit të Lartë, në Tiranë, Durrës, Shkodër dhe Vlorë, konkretisht:

- 1.Fakulteti i Drejtësisë;**
- 2. Kolegji Universitar “Ëisdom”;**
- 3. Klinika e Ligjit Shkodër;**
- 4.Universiteti “Aleksandër Mojsiu” Durrës;**
- 5. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë;**
- 6.“Universiteti European i Tiranës”;**
- 7. “Universiteti “Qirjazi”**
- 8. Universiteti “Bedër”**
- 9. Universiteti “Mesdhetar”**
- 10. Universiteti “Marin Barleti”**
- 11. Universiteti “Luarasi”**
- 12. Universiteti “Epoka”.**

Referuar nenit 7 të marrëveshjeve Tip të bashkëpunimit: Klinikat Ligjore do të dëgojnë të dhëna periodike çdo muaj pranë Drejtorisë së Ndhmës Juridike Falas mbi personat të cilët kanë aplikuar/përfituar ndihmë juridike parësore. Të dhënat do të dërgohen brenda 5(pesë) ditëve të para të muajit pasardhës të muajit referues.

Këto institucione kanë vendosur në dispozicion të qytetarëve zyra të brendshme të përshtatshme për pritjen e klientëve, të aksesueshme edhe nga persona me aftësi të kufizuar. Klinikat, referuar marrëveshjes së bashkëpunimit do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike parësore sipas

standardeve të përcaktuara nga Ministri i Drejtësisë dhe së bashku me qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore dhe organizatat jofitimprurëse të autorizuara do të ofrojnë ndihmë juridike parësore falas për çdo subjekt përfitues sipas përcaktimeve të ligjit nr. 111/2017.

Për muajin Prill janë administruar 0 raste nga Klinikat e Ligjit pranë IAL-ve

Klinikat e ligjit	Totali i Rasteve të trajtuara	Mosha		Gjinia		Shtetësia		Kategoritë përfituese (Specifiko Kategorinë)			Natyra e Cështjes			Përkatësia Etnike	Viktima dhune
		Mitur	Rritur	Femër	Mashkull	Shqiptar	I huaj	Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme	Kategori e Vecantë	Papërcaktuar	Civile	Penale	Administrative		
Kolegji Universitar Ēisdom	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Aleksandër Moisiu Durrës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kolegji universitar Bedër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Kolegji Universitar Qiriazi	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Mesdhetar	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Europjan i Tiranës	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Fakulteti i Drejtësisë, UT	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti Ismail Qemali Vlorë	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Klinika e ligjit në Shkodër	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti “Marin Barleti”	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
Universiteti “Epoka”	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-

TOTALI	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-	-
---------------	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---	---

Të dhëna statistikore mbi rastet e raportuara nga platforma Juristionline dhe Numri i Gjellbër 08001010

Ministria e Drejtësisë në bashkëpunim me Fondacionin Shoqëria e Hapur për Shqipërinë, për të garantuar aksesin e qytetarëve nëpërmjet ndihmës juridike falas, ka mundur për të gjithë qytetarët ofrimin e shërbimeve ligjore online përmes **platformës juristionline.al**. Përmes kësaj platforme çdo qytetar ka mundësi të këshillohet dhe informohet lidhur me aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor, dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore.

Pyetjet e dërguara në këtë platformë, që nga fillimi i funksionimit të saj, kanë qenë të shumëllojëshme duke theksuar edhe njëherë nevojën që kanë patur qytetarët për një sistem të tillë i cili deri më tani figuron të jetë mjaft rezultativ sidomos në kushtet kur në vend filloi ndërmarrja e masave kufizuese si pasojë e përhapjes së infeksionit të shkaktuar nga virusi (Covid-19).

Kjo platformë ka rezultuar mjaft e suksesshme pasi vëhet re një numër i konsiderueshëm qytetarësh të cilët i janë drejtuar me qëllim marrjen e një orientimi ligjor mbi problematikat e tyre edhe pas përfundimit të gjendjes së fatkeqësisë natyrore. ***Duke marrë në konsideratë natyrën e këtij shërbimi dhe duke qenë se qytetarët mund të parashtronë problematikën e tyre në këtë platformë thjesht përmes adresimit të një pyetjeje, pa qenë nevoja për të plotësuar të dhëna shtesë të përcaktuara në formularët për përfitimin e ndihmës juridike parësore, të dhënat statistike që mund të pasqyrojnë përkohë vetëm me natyrën e çështjes (civile/penale apo administrative)***

RASTET E TRAJTUARA PRILL 2022 - 151 RASTE


Numri i Gjellbër 08001010

Në funksion të masave të shtuara, të ndërmarra për qytetarët që kanë nevojë për shërbime të ndihmës juridike parësore, Ministria ka vendosur në dispozicion një linjë të gjellbër në të cilën kanë akses falas të gjithë qytetarët për shërbime të ndihmës juridike. Vendosija e një numri falas është një garanci më shumë për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike falas duke siguruar për qytetarët disponibilitet në çdo kohë dhe përmes disa formave. ***Si platforma juristionline ashtu edhe linja e gjellbër janë masa të shtuara duke garantuar shërbime profesionale dhe me standard të lartë dhe duke qenë sa më pranë qytetarit. Nga të dhënat e administruara nga Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas rezulton se qytetarët kanë shfaqur mjaft interes në përfitimin e këtij shërbimi ligjor gjë që përbën një hap mjaft pozitiv në kuadër të garantimit të aksesit në drejtësi për qytetarët.***


NUMRI I RASTEVE TË TRAJTUARA (Numri i gjelber 08001010)

TOTALI I RASTEVE (Telefonatave) 15


Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore




**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të raportuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike
parësore (sipas gjinisë)**



**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore
(sipas natyrës së çështjes)**




**Të dhëna statistikore mbi numrin e rasteve të trajtuara nga çdo ofrues i shërbimit të ndihmës juridike parësore
(sipas kategorisë përfituese)**



Totali i rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore për muajin Prill 2022

622 raste



KREU 2: TË DHËNA STATISTIKORE MBI ÇËSHTJET ME OBJEKT NDIHMËN JURIDIKE DYTËSORE

1. Të dhëna statistikore: Sipas ndarjes gjinore, Gra dhe Burra.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Prill 2022, rezulton se për **101 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike falas, **72** prej tyre rezultojnë për kërkuese gra (**71.2%**) dhe **29** prej tyre për kërkues burra (**28.7%**). Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi kërkuesit sipas ndarjes gjinore, Gra dhe Burra PRILL 2022		
Kategoria Gra / Burra	Numri i kërkuesve	Komente / të tjera
Kërkues Gra	72	Në vijimësi të trendit të zakonshëm, kërkuesit e ndihmës juridike falas për muajin Prill 2022 janë më shumë gra se kërkuesit burra.
Kërkues Burra	29	
<u>TOTALI = 101 Vendime Gjyqësore</u>		

2. Të dhëna statistikore: Sipas kategorive përfituese, me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme / kategori e veçantë.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Prill 2022, rezulton se nga **101 vendime** gjyqësore në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, **65** prej tyre rezultojnë për kërkues që pretendojnë se i përkasin kategorisë së personave me pasuri dhe të ardhura të pamjaftueshme (**64.3%**) dhe **36** prej tyre rezultojnë nga kërkues që bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta sipas ligjit (**35.6%**).

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi kërkuesit sipas kategorive përfituese PRILL 2022		
Kategoria përfituese		Numri i kërkuesve
Të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme		65
E pa specifikuar në vendimin gjyqësor		0
Kategori e veçantë (Total 36)	Viktimë dhune / diskriminimi	12
	Person me aftësi ndryshe / statusi i të verbërit	13
	Përfitues nga skema e mbrojtjes sociale	11
	Komuniteti Rom	0
	Fëmijë dhe të mitur	0
<u>TOTALI = 101 Vendime Gjyqësore</u>		

3. Të dhëna statistikore: Lloji i ndihmës dytësore të kërkuar nga qytetarët.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Prill 2022, rezulton se nga **101 vendime** gjyqësore në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, **23** prej tyre janë kërkesa për dhënie e ndihmës juridike dytësore me avokat, **68** prej tyre janë kërkesa për dhënie e ndihmës juridike dytësore me avokate dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe **10** prej tyre janë kërkesa për përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore. Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore mbi llojin e ndihmës dytësore të kërkuar PRILL 2022		
Lloji i ndihmës dytësore të ofruar	Numri i Përfituesve	Komente / të tjera
Ndihmë juridike dytësore me avokat	23	Në analizë të së tërës, shihet që në pjesën më të madhe, kërkuesit kërkojnë ndihmën juridike të përfaqësimit me avokat si dhe përjashtimin nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore.
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	68	
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	10	
TOTALI = 101 Vendime Gjyqësore		

4. Të dhëna statistikore: Sipas vendimmarrjes së Gjykatave / Organit procedues për kërkesat.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Prill 2022, nga **101 vendime gjyqësore** në total me objekt kërkesën e ndihmës juridike, rezulton se janë pranuar **100** kërkesa për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore (**99%**) dhe janë rrëzuar **1** kërkesa për përfitim nga ndihma juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore (afërsisht **1%**).

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore vendimmarrjes së gjykatave ose organit procedues PRILL 2022			
Lloji i ndihmës dytësore të ofruar	Vendimi i Gjykatës / Organit Procedues Pranim / rrëzim pranim pjesërisht	Numri i Kërkuesve	Komente / të tjera
Ndihmë juridike dytësore përfaqësim me avokat	Pranuar	23	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm evidentohet një numër i ulët (po thuajse 0) i vendimeve që rrëzojnë kërkesën e ndihmës juridike. 2. Në analizë të së tërësi, nuk evidentohet raport i caktuar ndërmjet refuzimeve përsa i përket llojit të ndihmës juridike.
	Rrëzuar	0	
Ndihmë juridike dytësore dhe përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	Pranuar	68	
	Rrëzuar	0	
Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore	Pranuar	9	
	Rrëzuar	1	
<u>TOTALI = 101 Vendime Gjyqësore</u>			

5. Të dhëna statistikore: Lloji i çështjes për të cilën kërkohet ndihmë juridike.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Prill 2022, rezulton se nga **101 vendime** gjyqësore në total me objekt kërkesën për ndihmën juridike, **81** prej tyre janë çështje civile (**80%**), **12** janë çështje administrative (**11.8%**), dhe **7** janë çështje penale (**6.9%**).

Ndërsa për **1** përfitues nuk mund të evidentohet statusi.

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore sipas natyrës së çështjes gjyqësore që kërkohet ndihma PRILL 2022		
Lloji i çështjes	Numri i kërkuesve	Komente / të tjera
Çështje civile (pronësie, pjestim pasurie, vjetërsi pune)	81	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm evidentohet që në pjesën dërrmuese ndihma juridike kërkohet për çështje civile. 2. Krahimisht evidentohet një rritje e lehtë e çështjeve administrative.
Penale	7	
Administrative	12	
N/A	1	
<u>TOTALI = 101 Vendime Gjyqësore</u>		

6. Të dhëna statistikore: Sipas gjykatave që ka dhënë vendimin.

Nga të dhënat e administruara nga DNJF gjatë muajit Prill 2022, rezulton se nga **101 vendime gjyqësore** në total me objekt ndihmën juridike, **të gjitha i përkasin** Gjykatave të Rretheve Gjyqësore dhe **13 vendim** janë dhënë nga Gjykatat Administrative të Shkallës së Parë si dhe **2 vendime** nga Gjykata e Apelit. Këto vendime sipas gjykatave respektive janë të ndara si më poshtë:

Këto të dhëna paraqiten në formë tabelare si vijon:

Të dhëna statistikore sipas gjykatave që kanë dhënë vendimin PRILL 2022			
Gjykata që ka dhënë vendimin me objekt ndihmën juridike		Numri i vendimeve gjyqësore	Komente / të tjera
Gjykata e Rrethit Gjyqësor	Tiranë	16	1. Në vijimësi të trendit të zakonshëm, numri u vendimeve i përket në pjesën më dërrmuese gjykatave të rrethit krahasimisht me gjykatat administrative.
	Durrës	5	
	Elbasan	4	
	Fier	5	
	Gjirokastrë	2	
	Korçë	1	

	Lezhë	11	2. Tërë vendimet gjyqësore për kërkesat mbi ndihmën juridike janë përcjellë nga 12 gjykata të rretheve gjyqësore.
	Lushnje	8	
	Berat	6	
	Pogradec	12	
	Vlorë	5	
	Shkodër	9	
	Dibër	0	
	Përmet	0	
	Sarandë	0	
	Kurbin	2	
	Tropojë	0	
Gjykata Administrative e Shkallës së Parë	Tiranë	7	
	Durrës	2	
	Shkodër	2	
Gjykata e Apelit	Tiranë	1	
	Shkodër	1	
Total = 0 Vendime gjyqësore			
TOTALI =101 Vendime Gjyqësore			

KONKLUSIONE

Sa i përket Ndhmës Juridike parësore

- ✓ Nga rastet e administruara për muajin **Prill 2022**, në total rezultojnë **598 raste** nga të cilat **259 raste janë trajtuar nga Qendrat** e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore; **197 raste janë trajtuar nga Organizatat** Jofitimprurëse të autorizuar nga Ministri i Drejtësisë; **151 raste janë trajtuar nga Platforma** juristionline.al si dhe **15 raste** janë trajtuar përmes **numrit të gjelbër 08001010**.
- ✓ Nga analiza e këtyre të dhënave, në krahasim me muajin Mars, konstatohet një rritje e lehtë e rasteve të trajtuara nga ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore.
- ✓ Sa i përket organizatave jofitimprurëse të autorizuar, organizatat me numrin më të lartë të rasteve të trajtuara vijnë të mbeten: **Qendra për Nisma Ligjore Qytetare dhe TLAS**.
- ✓ Vlen të evidentohet performanca e Qendrave të Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore në **Tiranë, Gjirokastrë dhe Durrës** ndërsa qendrat që ende kanë nevojë për një promovim të shtuar janë Qendra e **Pogradecit dhe Dibrës**.
- ✓ **Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë**, pavarësisht rikthimit të studentëve në auditorë dhe zhvillimin e mësimin në kushte normale, **vijnë të mos raportojnë të dhëna**.
- ✓ Fokus shumë i madh po i kushtohet grupeve dhe kategorive vulnerabël dhe në këtë kuadër, nga analiza e të dhënave konstatohet se ofruesit e shërbimit të ndihmës juridike parësore kanë trajtuar një numër të konsiderueshëm të rasteve ku përfitues janë kategoritë në pamundësi financiare;
- ✓ **Vihet re një numër i ulët rastesh kur përfitues kanë qenë të miturit apo personat që i përkasin kategorive rome apo egjiptiane**. Si rrjedhojë, nevojitet një vëmendje e shtuar përmes zhvillimit të aktiviteteve ndërgjegjëse të dedikuara për këto kategori.
- ✓ Për muajin Prill 2022 nuk kanë raportuar “*Qendra e Këshillimit për Gra dhe Vajza*”, dhe “*Qendra Konsumatori Shqiptar*”;
- ✓ Së fundmi, sa i përket mënyrës së raportimit të të dhënave konform udhëzimit nr. 1/2019, të Ministrit të Drejtësisë, **vihet re se disa nga ofruesit vijnë të mos përcjellin të dhënat sipas formatit të kërkuar** (duke mos specifikuar kategoritë e veçanta përfituese të ligjit). Lidhur me këtë problematikë, i bëjmë thirrje ofruesve të respektojnë elementët e përcaktuar në udhëzimin nr.1, datë 08.03.2019, “*Për miratimin e rregullave dhe procedurave për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrave*”).

Sa i përket Ndhmës Juridike Dytësore

-  Nga vendimet gjyqësore me objekt ndihmën juridike falas, të administruara nga DNJF për muajin Prill 2022, **në total rezultojnë 101 vendime** gjyqësore nga të cilat në **100 vendime janë pranuar** kërkesat për ndihmë juridike dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore dhe në **1 vendim janë rrëzuar, pushuar gjykimi, ose kthyer aktet nga gjykata** lidhur me kërkesat për ndihmë juridike dytësore dhe/ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore; për mos plotësim dokumentaconi/ mospërmbushje të kriterëve të ligjit.
-  **Lidhur me** kategorinë përfituese nga shërbimi i ndihmës juridike, numrin më të madh të të cilëve e përbën gjinia femërore. (72 *përfitues femra dhe 27 përfitues meshkuj*).
-  Numrin më të madh të vendimeve e përbëjnë çështjet civile (*pronësie, pjestim pasurie, heqje zotësie për të vepruar, vjetërsi pune, caktim kujdestarie*)
-  **Lidhur me Gjykatat që kanë dhënë vendimet me objekt ndihmën juridike** dytësore dhe / ose përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore, rezulton se: për muajin Prill 2022, **numrin më të madh të vendimeve e ka dhënë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë**, e pasuar nga **Gjykata e Rrethit Gjyqësor Pogradec**.

Konkluzione

NDIHMA JURIDIKE PARËSORE JANAR- PRILL 2022

Muaji	Qendrat e Shërbimit të Ndhmës Juridike Parësore	Organizatrat jofitimprurëse të autorizuara	Klinikat e Ligjit pranë IAL	Platforma juristonline	Numri i gjelbër	Total
Janar	296	224	0	123	24	667
Shkurt	276	236	0	126	20	658
Mars	251	221	0	127	20	619
Prill	259	197	0	151	15	622
Maj						

Qershor						
Korrik						
Gusht						
Shtator						
Tetor						
Nentor						
Dhjetor						
Total						2566

Total Ndihma Juridike Parësore: 2566 raste të raportuara

NDIHMA JURIDIKE DYTËSORE JANAR- PRILL 2021

<i>Vendime Gjyqësore me Objekt Ndihmën Juridike</i>
JANAR – PRILL 2021
<i>Totali i Vendimeve Gjyqësore = <u>309 vendime</u></i>